



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 10 VENDIMI

Tiranë, më 28.03.2018

VENDIM

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesues
Roland Ilia	Anëtar
Xhensila Pine	Relator

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Ina Serjanaj;
pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, në datën
28.03.2018, ora 15:00, në sallën nr. 1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në
shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z.Illir Çeliku - Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë

BAZA LIGJORE : Neni 179/b, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 56
e 57, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe
prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Arsyet për pushimin e procesit të rivlerësimit:

Subjekti i rivlerësimit, Ilir Çeliku, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit
Vlorë.



Ky subjekt, ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, në datën 27.01.2017.

Kjo dorëheqje është protokolluar pranë këtij institucioni, me nr.2/I prot., datë 30.01.2017. Presidenti i Republikës e ka publikuar këtë fakt në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmjet shkresës nr.688/1 prot., datë 19.03.2018, ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, Ilir Çeliku.

Ky subjekt e ka paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr.17, datë 10.02.2017, ka deklaruar mbarimin e statusit për shkak dorëheqjeje të gjyqtarit Ilir Çeliku, bazuar në pikën I, germa “ë”, e nenit 160, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

“Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3¹, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin² dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim³, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në datën 25.10.2016. Në datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.01.2017. Si rezultat afati 3-mujor, parashikuar nga neni 56, ka përfunduar në datën 31 mars 2017.

¹Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 85. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

²Pas miratimit nga Parlamenti në datën 22 korrik 2016, dhe kalimit të afatit 20-ditor, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vendosi pezullimin e zbatimit të ligjit nr.84/2016 dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ Në datën 18.01.2017, me vendimin nr.2, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit.

Paraqitja e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit brenda këtij afati, sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit, duke i dhënë këtij subjekti të drejtat e parashikuara në pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 56 dhe 57, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Të deklarohet se procesi i rivlerësimit kalimtar për Z. Ilir Çeliku, Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, është pushuar.

Ky vendim u njoftohet Z. Ilir Çeliku, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditë nga data e njoftimit të tij dhe duhet të depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

VALBONA SANXHAKTARI
Kryesues

XHENSILA PINE
Relator



ROLAND ILIA
Anëtar



Ky vendim shpallet në datën 28.03.2018.